

Ysaia Ploua
24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar "Aleanca për Ndryshim"

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 22.04.2024

Lënda: Propozim nisme ligjore të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ju paraqes për shqyrtim dhe miratim nismën ligjore të një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar "Aleanca për Ndryshim", "Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2018 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

Kjo nismë ka për qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator të Kodit Zgjedhor, bazuar në disa problematika të vërejtura nga praktika jonë zgjedhore si;

- Funksionimi i koalicioneve zgjedhore, paraqitja e listave të përbashkëta dhe të përbëra të koalicioneve.
- Sistemi i zgjedhjeve për Kuvend dhe ato Vendore por zgjedhja në Kuvend nëpërmjet sistemit me kuotë të plotë proporcionale dhe shpërndarjen e mandateve të fituara nga çdo subjekt në nivel zone zgjedhore dhe në nivel kombëtar me korrektim.
- Garantimin e së drejtës së zgjedhësve për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëëmërore.
- Shpërndarjen e mandateve me metoda që bazohet tërësisht në rezultatet e votimit parapëlqyes të të gjithë kandidatëve (votimit me lista tërësisht të hapura).
- Etj.

Propozimet synojnë përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën e Shqipërisë dhe standartet ndërkombëtare mbi zgjedhjet, të njohura e të pranuar nga shumë vende anëtare të OSCE/ODIHR.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Agon DUKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e një grup deputetësh të Grupit Parlamentar “Aleanca për Ndryshim”,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 2, pas numrit 31 bëhen shtesat si vijon:

Neni 2

Përkufizime

“ **32.** “Listë shumëemërore e përbashkët” është lista e kandidatëve të një koalicioni, i cili paraqitet si subjekt i vetëm në fletën e votimit.”

“ **33.** “Listë shumëemërore e përbërë” është lista shumëemërore e kandidatëve të një koalicioni që përbëhet nga lista të veçanta të partive përbërëse të koalicionit, të cilat paraqiten veçmas në fletën e votimit.”

Neni 2

Në nenin 7, pas gërmës ç të pikës 1, shtohet gërma “d”, me këtë përmbajtje:

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

“ Të pajiset me kopjet e vendimeve, protokolleve, tabelave, proces-verbaleve, dhe cdo dokument tjetër gjatë gjithë procesit zgjedhor, përfshirë proceset para dhe pas ditës së zgjedhjeve”.

Neni 3

Në nenin 19, pika 1 gërma j), riformulohet si vijon:

Neni 19

Kompetencat e komisionerit

“ j) Prodhon, boton, publikon të dhëna statistikore për zgjedhjet në vite, të dhëna statistikore për raportet gjinore në zgjedhje, administrimin e tyre, në kandidim dhe në organet e zgjedhura, si dhe të dhënat për listat e kandidatëve të Kuvendit dhe të organeve të qeverisjes vendore;”

Neni 4

Në nenin 22, fjalia e dytë e pikës 1, riformulohet si vijon:

Neni 22

Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje

“ 1. “KQZ-ja është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose paisjeve të teknologjisë së informacionit, t`a zbatojë brenda datës 1 Prill 2025 në të gjitha qendrat e votimit dhe vendit të numërimit të votave në të gjithë vendin”.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, alokon në buxhetin e KQZ-së fondin e nevojshëm për prokurim, jo më vonë se data 1 korrik 2024.

Neni 5

Në nenin 52, pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

Neni 52

Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

“ 7. Për shkeljen e përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 6 të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, personi i ngarkuar me lajmërimin/njoftimin me shkrim të zgjedhësit, dënohet me gjobë nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë”

Neni 6

Në nenin 63, në referim të përcaktimeve në nenin 69 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet si vijon:

Neni 63

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët

- Pas fjalisë së fundit të pikës 3, bëhet një shtesë si vijon:

“ 3.

Kandidati për organet e qeverisjes vendore duhet të jetë shtetas me vendbanim në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.”

- Pika 4 riformulohet:

“ 4. Përvec kushteve të parashikuara në pikën 3, nuk mund të kandidojnë, as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:”

- Gërma “d” e pikës 4 riformulohet si vijon:

“Kryetarët e bashkive si dhe prefektët në vendin ku ata kryejnë detyrat e tyre”

- Gërma “e” e pikës 4;

“Shfuqizohet”

Neni 7

Në nenin 65, pikat 1 dhe 3 riformulohen si vijon:

Neni 65

Rregjistrimi i koalicioneve zgjedhore

“ 1. Dy ose më shumë parti politike të rregjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të rregjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve, duke paraqitur marrëveshjen përkatëse të koalicionit. Marrëveshja duhet të përcaktojë nëse partitë përbërëse të koalicionit do të paraqiten në votimin proporcional veçmas në fletën e votimit ose nëse koalicioni do të paraqitet si subjekt i vetëm.

“ 3. Në momentin e rregjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevoja të zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore, përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre, rregjistrohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.

Marrëveshjet e koalicionit zbatohen drejtpërdrejtë nga KQZ-ja kur ato përmbajnë:

- a) Datën e krijimit, të dhënat mbi përbërjen dhe emërtimin e koalicionit.
- b) Listën shumëemërore të përbërë, kur partitë e koalicionit paraqiten veçmas në fletën e votimit ose listën shumëemërore të përbashkët, kur koalicioni paraqitet si subjekt i vetëm.

Neni 8

Neni 67 ndryshohet pikat 3-4 dhe shtohet pika 8 me përmbajtjen si vijon:

Neni 67

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Shfuqizohen fjalitë vijuese pas fjalisë së parë”

“ 3. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumëemërore në një zonë zgjedhore, ose kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë, nuk mund të rregjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as i propozuar nga një grup zgjedhësish”.

- Pika 4, riformulohet si vijon:

“4. Emrat e kandidatëve në listën shumëemërore në shkallë zone zgjedhore dhe në rang vendi të subjektit zgjedhor, paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumëemërore për Ω -do parti politike, duhet të jetë jo më i vogël se tre dhe jo më i madh se numri i mandateve të caktuara në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar deri një me qëllim që numri i kandidatëve në listën shumëemërore për zgjedhjet në Kuvend të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre, ndërsa për zgjedhjet e këshillave vendore, me numrin dy.

Në fillim të listës shumëemërore renditen emrat e kandidatëve të cilët zgjidhen bazuar në renditjen e tyre të pandryshueshme dhe pas tyre renditen kandidatët e tjerë vijues të listës, të cilët renditen nga KQZ-ja bazuar në rezultatin më të madh të votave parapëlqyese që ka marrë secili prej tyre.

Për qëllimet e këtij Kodi, koalicioni dhe partitë pjesëtare të tij, si dhe partitë e tjera politike, sëbashku me listat shumëemërore të tyre, depozitojnë deklaratën me shkrim, për caktimin e renditjes së pandryshueshme të kandidatëve në listë, por jo më shumë se një të tretën e numrit të përgjithshëm të kandidatëve të listës shumëemërore, si dhe numrin rendor të renditjes së gjithësecilit prej tyre.

Gjithashtu deklarohen dhe kandidatët vijues të përfshirë në listën shumëemërore së bashku me numrin rendor të gjithësecilit, të cilët do të renditen në KQZ pas llogaritjes së shpërndarjes së mandateve, bazuar në numrin/përqindjen më të lartë të votave parapëlqyese që ka fituar secili prej tyre.

Deklarata nënshkruhet nga kryetari i partisë. Në rastin e koalicioneve të cilat paraqiten me listë të përbashkët, sëbashku me nënshkrimet e tyre nga kryetari i koalicionit, deklarata nënshkruhet edhe nga kryetarët e partive pjesëtare të koalicionit, të cilët përfaqësohen me kandidatët e tyre në listën shumëemërore përkatëse.

- Pas pikës 7, shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Në rast të vdekjes apo dorëheqjes së kandidatit, jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve, një subjekt zgjedhor mund të zëvendësojë kandidatin brenda një date të caktuar posacërisht nga KQZ”.

Neni 9

Në pikën 1 të nenit 68, pas togfjalëshit “jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

Neni 68

Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve

“Bën përjashtim nga ky rregull, partia e cila në tre zgjedhjet e fundit ka fituar mesatarisht jo më pak se 0.5% të votave të vlefshme në shkallë vendi.....”.

Neni 10

Në pikën 1, gërma c, të nenit 101, pas fundit të fjalisë, shtohet togfjalëshi me këtë përmbajtje:

Neni 101

Veprime paraprake të KQZ-së

“..si dhe listat e kandidatëve të të gjitha partive politike të rregjistruara si subjekte zgjedhore, në përputhje me përcaktimet e nenit 67 të këtij Kodi”

Neni 11

Në nenin 118 bëhet ky ndryshim: Në fjalinë e parë të pikës 6, pas togfjalëshit “për cdo subjekt zgjedhor”, shtohet:

Neni 118

Vlerësimi i votave

“ 6.”dhe kandidatët e tij.

Neni 12

Titulli i pjesës XII të këtij Kodi, riformulohet si vijon:

“SISTEMI I ZGJEDHJEVE DHE NDARJA E MANDATEVE PËR KUVENDIN”

Neni 13

Titulli dhe përmbajtja e nenit 162 riformulohet si vijon:

Neni 162

Përlllogaritja e mandateve zgjedhore , - bëhet:

“ Përbërja e Kuvendit dhe përlllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore”

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurim rajonal dhe prag kombëtar. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumëemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.
2. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore, nga koalicionet zgjedhore, partitë politike si dhe nga zgjedhësit.
3. Listë shumëemërore korrektuese në shkallë vendi, paraqesin vetëm partitë politike dhe koalicionet zgjedhore, të cilët kanë paraqitur lista shumëemërore në zonat zgjedhore të vendit. Kandidatët e listave shumëemërore në nivel zone zgjedhore, janë njëkohësisht edhe kandidatë të listës shumëemërore konkurrese në shkallë vendi.
4. Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore dhe atyre në shkallë vendi, apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo subjekt zgjedhor, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore dhe në shkallë vendi.

Për zgjedhjet për Kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve të përlllogaritura nga korrektimi i votave në shkallë vendi, subjektet që kanë marrë më pak se 0.5 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

5. Quhet i zgjedhur deputet;
 - a) Kandidati i propozuar nga zgjedhësit, i cili përfiton mandatin bazuar në numrin mesatar të votave për një deputet, që ai ka fituar në zonën zgjedhorepërkatëse.
 - b) Kandidati i listës shumëemërore të koalicionit apo partisë politike, i cili është renditur në mënyrë të pandryshueshme në listë, duke filluar nga numri rendor një, deri në numrin e caktuar në këtë renditje, por jo më shumë se në një të tretën e listës, në përputhje me deklaratën me shkrim, të nënshkruar nga kryetari i subjektit zgjedhor, për renditjen e kandidatëve të listës shumëemërore. Teksti i deklaratës për kandidatët që marrin mandat bazuar në renditjen e tyre, përcaktohet nga KQZ-ja.
 - c) Kandidati i listës shumëemërore, sipas rirenditjes së tij së tij në listë nga KQZ, bazuar në numrin më të madh të votave parapëlqyese të fituara nga secili kandidat.

6. Në rast se dy a më shumë subjekte, fitojnë numër apo përqindje të barabartë votash, atëherë organizohet hedhja e shortit nga KQZ-ja në seancë publike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, kandidatëve si dhe subjekteve të interesuara.
7. **Shpërndarja e mandateve për subjektet zgjedhore;** koalicione, parti dhe kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, bëhet sipas rregullave të mëposhtme:
- Për shpërndarjen e mandateve në nivel zone zgjedhore, numri i votave të vlefshme gjithsej që kanë fituar sëbashku të gjitha subjektet zgjedhore, pjesëtohen me numrin e mandateve të zonës zgjedhore përkatëse. Herësi i përfituar nga ky pjesëtim, përfaqëson kuotën mesatare të votave për një mandat në atë zonë zgjedhore.
 - Votat e vlefshme që ka fituar cdo subjekt, koalicion, parti apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, pjesëtohet me kuotën mesatare të votave të llogaritur sipas gërmës “a” të kësaj pike. Herësi i plotë i përfituar nga ky pjesëtim, përfaqëson numrin e mandateve të plota që fiton subjekti zgjedhor në atë zonë zgjedhore.
 - Kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili ka konkuruar me listë shumëëmërore të përbërë, shpërndarja e mandateve për partitë pjesëtare të koalicionit, bëhet bazuar në numrin e votave të vlefshme gjithsej, të fituara nga koalicioni në zonën zgjedhore përkatëse, i cili pjesëtohet me numrin e mandateve të fituara nga ai koalicion, në atë zonë zgjedhore. Herësi i përfituar nga ky pjesëtim, përfaqëson kuotën mesatare të votave të koalicionit për një mandat, në zonën zgjedhore përkatëse.
 - Për shpërndarjen e mandateve për secilën parti pjesëtare të koalicionit që ka konkuruar me listë të përbërë, bëhet duke pjesëtuar me numrin e votave që ka fituar secila parti, me kuotën e votave për një mandat të koalicionit përkatës. Herësi i plotë i përfituar nga ky pjesëtim, përfaqëson numrin e plotë të mandateve që fiton partia e koalicionit në atë zonë zgjedhore.
8. Mandatet që mbeten pa u shpërndarë për cdo subjekt zgjedhor, koalicion dhe parti politike, në nivel zone zgjedhore, do t`u shpërndahen në rang vendi këtyre subjekteve, bazuar në rezultatin zgjedhor të korrektuar në shkallë vendi, për gjithsecilën prej tyre.
9. **Shpërndarja e mandateve për subjektet nëpërmjet korrektimit të rezultatit në shkallë vendi,** bëhet sipas rregullave të mëposhtme:
- Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme gjithsej që kanë fituar subjektet zgjedhore, pasi zbriten nga ky numër votat që kanë marrë kandidatët e propozuar nga zgjedhësit të cilët nuk kanë mandat, si dhe votat që kanë fituar subjektet të cilët nuk kanë arritur pragun elektorale kombëtar prej 0.5 %, pjesëtohet me numrin e mandateve të Kuvendit, të cilit i është zbritur numri i mandateve që kanë fituar kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Herësi i përfituar nga ky pjesëtim, përfaqëson kuotën mesatare të votave në shkallë vendi për një mandat.
 - Numri i votave gjithsej në shkallë vendi që ka marrë cdo subjekt zgjedhor, koalicione dhe parti politike që kanë konkuruar të vetme, pjesëtohet me kuotën e votave për një mandat në shkallë vendi. Herësi i plotë i përfituar nga ky pjesëtim përfaqëson numrin e plotë të mandateve që fiton secili nga këto subjekte.
 - Nga numri i mandateve të llogaritura si më sipër për koalicionet dhe partitë politike, zbritet numri i mandateve të fituara prej tyre në shkallë zone zgjedhore. Mbetja përfaqëson numrin e mandateve që do t`u shpërndahen subjekteve si më sipër, të cilat përfitohen nga korrektimi në shkallë vendi i rezultatit zgjedhor.

- d) Në rast se nga numri i mandateve të llogaritura për t`u shpërndarë në shkallë vendi, mbeten ende pa u shpërndarë një numër i tyre, ato ndahen në favor të subjekteve që kanë marrë numrin më të lartë pas presjes dhjetore, të numrit të plotë të mandateve të llogaritura për ta. Në rast se mbetjet dhjetore pas mandatit të fundit janë të njëjta, ndarja e tyre përcaktohet me short.

Neni 14

Neni 163 riformulohet si vijon:

Neni 163

Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

2. Shpërndarja e mandateve në favor të kandidatëve të listës shumëemërore të partisë apo koalicionit të paraqitur me listë të përbashkët apo të përbërë, fillon nga numri rendor një i listës dhe vazhdon deri në kandidatin e fundit të renditur në mënyrë të pandryshueshme në listë sipas deklaratës së renditjes së kandidatëve të listës shumëemërore, të depozituar në KQZ, nga subjekti zgjedhor përkatës. Pas kësaj, shpërndarja e mandateve vazhdon me kandidatët vijues të listës shumëemërore sipas renditjes së tyre nga KQZ-ja.

3. Renditja e kandidatëve bëhet nga KQZ-ja bazuar në numrin më të lartë të votave parapëlqyese që ka marrë secili kandidat i listës shumëemërore, në rastin kur renditja bëhet në funksion të ndarjes së mandateve të llogaritura për t`u shpërndarë në nivel të zonës zgjedhore. Kur rirenditja bëhet për kandidatët e listës shumëemërore për korrektim në shkallë vendi, rirenditja bazohet në përqindjen më të lartë të votave parapëlqyese që ka fituar secili kandidat i asaj liste.

4. Rregullat e përcaktuara sipas pikës 3 të këtij neni, nuk zbatohen nëse kandidati që ka rezultatin më të ulët zgjedhor, i përket gjinisë më pak të përfaqësuar. Në këtë rast, zëvendësimi kalon tek kandidati tjetër i renditur më lart, deri në sistemimin e listës sipas së njëjtave kritere.

Neni 15

Pika 3 e nenit 165 riformulohet si vijon:

Neni 165

Sistemi i zgjedhjeve vendore

“ 3. Koalicionet zgjedhore paraqesin vetëm një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie dhe listë shumëemërore të përbashkët ose të përbërë kandidatësh për këshillat vendorë.”

Neni 16

Pas pikës 3 të nenit 166 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Neni 166

“ 3. _____

Kur ka marrëveshje të subjektit zgjedhor për renditjen përfundimtare të kandidatëve të listës shumëemërore, mandatet ndahen bazuar në marrëveshjen përkatëse të depozituar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 65 dhe 67 të këtij Kodi. Marrëveshja zbatohet drejtpërdrejt nga KQZ-ja kur përmban:

- a) Formulën e caktimit të renditjes përfundimtare të listës shumëemërore, e cila duhet të garantojë përmbushjen e kriterit që shpërndarja e mandateve fillon nga kandidatët të cilët renditen mbi bazën e përqindjes më të lartë të votave parapëlqyese të secilit kandidat.
- b) Marrëveshja të jetë nënshkruar nga secili kandidat dhe sipas rastit nga ktyetari i partisë udhëheqëse të koalicionit ose nga kryetarët e partive respektive përbërëse të koalicionit.

Neni 17

Në nenin 173 bëhen këto shtesa:

Neni 173

Sanksione në lidhje me financimin e fushatës

“ 3/1 Mospërmbushja nga ana e kandidatëve të subjekteve zgjedhore të detyrimit të tyre për transparencën e të ardhurave dhe shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore në përputhje me rregullat e standartizuara dhe miratuara nga KQZ-ja, passjell dënimin e kandidatëve përgjegjës me gjobë nga 100,000 deri në 500,000 lekë.

DEPUTETET NENSHKRUES:

Agim Duka
Fatmir Duka
[Signature]

Vangjel Dule *[Signature]*

RELACION

(Të propozuara nga deputetë të Grupit Parlamentar "Aleanca për Ndryshim")
"PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10019, DATË 29.12.2008
"KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR"

- I. Projektligji i propozuar nga deputetë të Grupit Parlamentar "Aleanca për Ndryshim", ka për qëllim:
 1. Garantimin e së drejtës për të votuar, për të zgjedhur dhe barazinë e votës për cdo shtetas shqiptar.
 2. Mbi funksionimin e koalicioneve zgjedhore dhe rritjen e bashkëpunimit elektoral të partive pjesëtare të tij, nëpërmjet përdorimit prej tyre të listave shumëemërore "të përbëra" apo "të përbashkëta", në përputhje me vullnetin e lirë të tyre.
 3. Marrëveshjet e koalicionit mbi përbërjen, emërtimin e koalicionit, si dhe rregjistrimin e listës së "përbërë" apo "të përbashkët" të tij, të zbatohen drejtpërdrejtë nga KQZ-ja.
 4. Për garantimin e së drejtës së zgjedhësve për të dhënë votën parapëlqyese të tyre, nëpërmjet hapjes tërësisht të listave të kandidatëve, për zgjedhjet në Kuvend si dhe Këshillat Vendore.
 5. Shpërndarja e mandateve të fituara nga cdo subjekt, bëhet në nivel zone zgjedhore dhe pjesa e mbetur e mandateve shpërndahet në nivel kombëtar, me metodën e korrektimit.
 6. Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës, të bazohet tërësisht në rezultatet e votimit parapëlqyes të të gjithë kandidatëve fitues të subjektit.
 7. Përdorimi i sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë, të zbatohet brenda datës 1 Prill 2025 në të gjitha qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave në rang vendi.
 8. Kufizimi i së drejtës së kandidatëve për t'u zgjedhur, do të bëhet vetëm në përputhje të plotë me përcaktimet kushtetuese.
 9. Numri i kandidatëve në listën shumëemërore të cdo partie politike, duhet të jetë jo më i vogël se tre, dhe jo më i madh se numri i mandateve të caktuara në zonën zgjedhore përkatëse.
 10. Lista e kandidatëve të një partie politike apo koalicioni zgjedhor, e cila nuk mbështetet nga numri i zgjedhësve të parashikuar në Kodin Zgjedhor, apo kur partia apo koalicioni nuk zotëron mandate në Kuvend apo Këshilla Vendorë, përjashtimisht do të rregjistrohet, në rastin kur partia në tre zgjedhjet e fundit ka fituar mesatarisht jo më pak se 0,5 % të votave në shkallë vendi.
 11. Shkelja e detyrimeve të parashikuara në nenin 52 të Kodit Zgjedhor "Për njoftimin me shkrim të zgjedhësve", kur nuk përbën vepër penale, personi përgjegjës dënohet me gjobë nga 500 mijë deri në 1 milionë lekë.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJEVE LIDHUR ME PËRPARËSITË DHE PROBLEMATIKA

a) Në vështrim të të gjitha reformave zgjedhore të kryera deri më sot, për rreth 3 dekada, faktori i brendshëm dhe ai ndërkombëtar, nuk kanë shprehur rezerva në cilësinë dhe pajtueshmërinë me standartet e këtyre reformave, por se ata kanë theksuar vazhdimisht dhe me këmbëngulje se reformat e kryera, janë karakterizuar nga pamjaftueshmëria e tyre për t'i dhënë zgjidhje çështjeve të cilat lidhen ngushtësisht me garantimin e lirisë dhe të drejtave themelore të qytetarëve në një proces politik të rëndësishëm në konfigurimin dhe legjitimitetin e pushteteve në vendin tonë.

Mungesa e adresimit për zgjidhje të këtyre shqetësimeve, kanë qenë dhe mbeten përgjegjësia më e lartë dhe kryesore, mungesa e së cilës thëllon edhe më tej destabilizimin politik të shoqërisë sonë.

Praktika zgjedhore, kryesisht pas vitit 2008, ka provuar në mënyrë të pakundërshtueshme shqetësimin e thëllë politik dhe publik, se Kodi Zgjedhor aktual ka sjellë ndikime negative në jetën politiko-shoqërore, duke përkeqësuar nivelin e demokracisë në vend.

Në dokumentin: "Zotimet ekzistuese për zgjedhjet demokratike në shtetet pjesëmarrëse të OSBE" në pikën 25 të tij përcaktohet se:

"Ndryshimet në ligj duhet të bëhen, sidomos në qoftë se mund të jetë shkelur aftësia e votuesve, partive politike, ose kandidatëve, për të luajtur rolin e tyre në zgjedhjet".

Koncepti kushtetues që zgjedhësi të zgjedhë apo të zgjidhet, nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm në aspektin e tij për pjesëmarrje në votime, por kjo duhet parë e lidhur ngushtë me mundësinë efektive të qytetarëve për të zgjedhur alternativën më të mirë që u ofrohet.

Modeli i sistemit zgjedhor i vendosur në vitin 2008 për mënyrën e shpërndarjes së mandateve nëpërmjet formulave Saimte-Lague dhe D/Hond, tashmë rezultojnë të testuar mjaftueshmërisht, dhe kontestuar nga shumica e faktorëve politikë në vend, si dhe nga e gjithë shoqëria civile, si model që deformat dukshëm vullnetin dhe leximin e votës së qytetarëve, duke rritur përfitimet e padrejta në favor të dy partive të mëdha politike.

Gjithashtu aplikimi i këtij modeli, solli si pasojë shkeljen e parimit kushtetues dhe standartet ndërkombëtare mbi barazinë e votës për një mandat përfaqësimi, si dhe thëlloi korrupsionin elektoral nëpërmjet premtimeve dhe shpërblimit me vende pune dhe privilegje të tjera kundrejt partive satelite të mazhorancës qeverisëse.

Në këto rrethana, shumica e zgjedhësve shqiptarë, rreth 80% e tyre, janë të bindur se nëpërmjet këtij modeli, përzgjedhja e tyre nuk reflektohet si përfaqësim në legjislativ dhe për këtë arsye tek ata është zhvilluar kriza e besimit politik në institucionet politikbërëse legjislative e qeverisëse dhe në tërësi në legjitimitetin e funksionimit të sistemit politik të vendit.

Modeli aktual i cilësuar si abuziv i shpërndarjes së mandateve për Kuvendin e Shqipërisë e Këshillat Vendore, i kombinuar ky me listat e mbyllura të kandidatëve të partive politike dhe në kombinim me rrethana të tjera politiko-sociale në vend (sic janë niveli i kulturës demokratike dhe institucionale brenda subjekteve politike, institucionet e dobëta, apo fuqia e krimin të organizuar) kanë tronditur thëllësisht demokracinë funksionale në vend, por dhe ka krijuar probleme të mëdha e serioze për zhvillimin e jetës politike të vendit.

b) Duke marrë parasysh parashtrimet sa më sipër, bëhet mjaft evident se **konkurimi në zgjedhje me lista partiake tërësisht të hapura** është një instrument efektiv për rritjen e avantazheve në një proces zgjedhor, nëpërmjet maksimalizimit të mundësive për zhvillimin e fushatës zgjedhore, rritjen e rezultateve elektorale dhe kontrollin e administrimit zgjedhor. Në këtë rast zgjedhjet do të karakterizohen nga një konkurrencë e lartë dhe tërësisht e motivuar.

c) Partitë politike në Shqipëri, ende nuk kanë arritur nivelin e duhur të një kulture demokratike. Për pasojë, organet e tyre të brendshme i kanë tepër të dobëta.

Në këto kushte, **vendimarrja për hartimin dhe renditjen e kandidatëve të tyre në lista, si për zgjedhjet në Kuvend, ashtu edhe në ato të Këshillave Vendore, vazhdojnë të mbeten një ekskluziv i kryetarit të partisë.**

Forca e kryetarëve të partive, për të "emëruar" deputetët e tyre, i ka bërë ata tepër të fuqishëm brenda partisë, pasi përmes renditjes së kandidatëve në listat shumëemërore, ata kanë në dorë karrierën politike për secilin prej kandidatëve për t'u zgjedhur deputetë.

Kur partia është në opozitë, përqëndrimi i pushtetit në duart e kryetarit të partisë, mund të nxisë destabilitetin politik. Aftësia "disiplinuese" e kryetarit të partisë, minimizon rezistencën e deputetëve, duke i detyruar ata të ndjekin hera herës edhe vendime ekstreme, të cilat shkojnë kundër bindjes apo interesit të tyre politik.

Nga ana tjetër, kur partia është në mazhorancë, përqëndrimi i pushtetit të kryetarit, vështirëson funksionimin demokratik të shtetit, duke çenuar jo në pak raste parimin e ndarjes së tre pushteteve. Kontrolli i kryetarit të partisë mbi shumicën në Kuvend, paraqet një sfidë dhe rrezik serioz për funksionimin e demokracisë në vend, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një legjislacioni që shkon në kundërshtim me interesin e përgjithshëm të shoqërisë. Këtu përfshihet dhe hartimi i ligjeve, të cilat favorizojnë aktorë të caktuar, duke dëmtuar konkurrencën e ndershme në treg dhe stabilitetin ekonomik të vendit dhe njëkohësisht duke u shndërruar në forca gjeneruese për financimin e zgjedhjeve nëpërmjet burimesh të kundraligjshme dhe që në të ardhmen të ushtrojnë influencën e tyre në vendimarrjet politike.

III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË AMENDAMENTEVE TË PROPOZUARA

Projektligjet e propozuara nga deputetë të grupit parlamentar "Aleanca për Ndryshim" synon të eliminojë barrierat ligjore që kufizojnë të drejtat kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Për këtë arsye, projektligji synon disa ndryshime thelbësore në Kodin Zgjedhor, duke mos çenuar në asnjë rast rregullimet kushtetuese aktuale në fushën e zgjedhjeve, por vetëm duke u kufizuar në disa rregullime teknike që do t'i kontribuojnë kuadrit ligjor zgjedhor në vendin tonë.

Propozimet kryesore në mënyrë të përmbledhur, i rendisim si më poshtë:

Së pari: Në kuadër të garantimit të së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë me vendbanim të përhershëm apo vendqëndrim të përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, **deputetët propozues të grupit parlamentar "Aleanca për Ndryshim", deklarojnë mbështetjen dhe angazhimin e tyre, për të kontribuar në hartimin dhe miratimin e një projektligji, i cili do të konsiderojë dhe përfshijë të gjitha draft-propozimet e paraqitura nga parti politike, organizata dhe shoqata të shoqërisë civile, për të garantuar në mënyrë të plotë të drejtën e votimit për diasporën, si dhe të**

rregullojë në mënyrë ezauruese, të gjitha procedurat e nevojshme që përmbushin qëllimin e këtij projektligji.

Me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në vitin 2020, u krijua për herë të parë baza ligjore që shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Shqipërisë, të votojnë në vendet ku ndodhen jashtë shtetit. KQZ-ja u ngarkua me detyrimin që të miratojë rregullat për rregjistrimin e votuesve jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit, si dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Në konsideratën e grupit të deputetëve nismëtarë, hartimi i një projektligji, i cili garanton të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, përbën një imperativ të Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa zbatimi i tij është një e drejtë dhe përgjegjësi e subjekteve të këtij ligji.

Shkalla e nivelit eventual të pritshëm për pjesëmarrjen në zgjedhje të diasporës shqiptare, pavarësisht nga faktorët politikë që e pretendojnë atë, përbën vecse një artificë penguese abuzive dhe aspak të arsyeshme, që të përbëjë një shkak të ligjshëm që do të mund të ndikojë në mos hartimin dhe miratimin e projektligjit për votimin e zgjedhësve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Së dyti: Ndalimi i koalicioneve parazgjedhore për konkurim brenda tyre apo kufizimi i koalicioneve para zgjedhore për paraqitjen për rregjistrim të listave shumëemërore të kandidatëve të të gjitha partive pjesëmarrëse të koalicionit, ka cënuar rëndë dhe në mënyrë arbitrare lirinë e partive të koalicionit në përzgjedhjen e mënyrës së organizimit dhe bashkëveprimit të tyre.

Njëkohësisht kjo pengesë e qëllimshme është iniciuar në mënyrë të vullnetshme për të ndikuar në rezultatet elektorale të koalicionit, duke krijuar potencialisht një sfidë mjaft problematike me pasoja në përfaqësimin e koalicionit si subjekt zgjedhor, partive pjesëtare të tij, por dhe vetë legjitimitetin e Kuvendit apo sipas rastit të Këshillit Vendor.

Kodi Zgjedhor, në nenin 2, pika 10 shprehet se:

“Lista shumëemërore” është lista e kandidatëve për deputetë apo këshilltarë bashkie, e hartuar në përputhje me këtë Kod”.

Referuar këtij përkufizimi, Kodi Zgjedhor nuk ka detyruar rregjistrimin e një liste të vetme në rastin e koalicioneve, por as ka ndikuar rregjistrimin nga ana e koalicionit qoftë një listë “të përbashkët” apo qoftë edhe listë shumëemërore “të përbërë”.

Por KQZ në mungesë të argumentave, ka bërë një interpretim të kufizuar të rastit, duke u bazuar në interpretimin prej saj të pikës 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, e cila shprehet se: “Numri i kandidatëve të listës shumëemërore, nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën përkatëse “. Ky formulim erdhi si një ndryshim i kësaj dispozite që mazhoranca ndërmori në mënyrë të njëanshme me 5 Tetor 2020, duke sjellë formulimin e dispozitës sipas përmbajtjes së mësipërme.

Mënyra e zbatimit të procedurave për rregjistrimin e listës së kandidatëve për rastin e koalicionit, bazuar vetëm në përmbajtjen strikte të nenit 67 pika 4, ka kufizuar në një shkallë shumë të lartë, jo vetëm mundësitë për të marrë pjesë si pjesëtare e një koalicioni, por edhe numrin e kandidatëve që do të mund të rregjistrohen në listën e koalicionit, në

rast se aplikohet rregjistrimi i listave shumëemërore të përbëra të një koalicioni. (Në interpretim të këtij argumenti, ju sjellim arsyetimin se, në rastin kur në disa zona zgjedhore numri i mandateve është shumë i vogël nga 3-5 mandate, atëherë në këto raste numri i partive pjesëtare të koalicionit që do të mund të përfaqësohet në to dhe vetëm me një kandidat të tyre, do të jetë i reduktuar nga 1 deri në 2 parti dhe për pasojë do të mund të humbisnin dhe të drejtën e përfaqësimit të alternativës së tyre.

Në përfundim të arsyetimit për sa sipër, deputetët nismëtarë gjykojnë se **ligjërimi i mundësive alternative për paraqitjen e kandidatëve të një koalicioni parazgjedhor nëpërmjet "listës shumëemërore të përbashkët" apo "listës shumëemërore të përbërë"** në të cilën përfshihen numri i plotë i kandidatëve të secilës parti pjesëtare të një koalicioni parazgjedhor, do të përbënte një zgjidhje që i shërben garancive për mos cënim arbitrar të të drejtave që duhet të gëzojnë subjektet në një garë zgjedhore.

Së treti: Projektligji propozon zbatimin e një sistemi zgjedhor përfaqësimi proporcional me lista të hapura. Në thelb të këtij propozimi qëndron sistemi proporcional rajonal dhe korrektimi i rezultatit në shkallë vendi.

Nismëtarët e këtij projektligji, besojnë dhe janë të bindur, se votimi dhe përzgjedhja e kandidatëve nëpërmjet listave të hapura, është një propozim i ndershëm, shkencërisht i bazuar dhe ligjërisht i lejueshëm.

Për të realizuar procesin e përzgjedhjes, subjekti politik zgjedhor duhet të depozitojë listën e tij shumëemërore në nivel qarku dhe votuesi të ketë mundësi përzgjedhje brenda listës, sipas preferencës së tij.

Një amendim i tillë do ta zhvendoste tërësisht pushtetin nga kryetarët e partive tek zgjedhësit. Gjithashtu listat tërësisht të hapura janë një instrument efektiv për rritjen e avantazheve të një procesi zgjedhor, nëpërmjet maksimalizimit të mundësive për zhvillimin e fushatës zgjedhore dhe në këtë rast, zgjedhjet do të karakterizohen nga konkurrenca e lartë dhe tërësisht e motivuar e kandidatëve në garë.

Nga ana tjetër, hapja tërësisht e listave do të kontribuojë ende më tej në funksionimin e demokracisë përfaqësuese nëpërmjet një sistemi përzgjedhje, i cili bazohet në vullnetin e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë përfaqësuesit e tyre.

Në rast se në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 25 Prill 2021, listat e kandidatëve do të kishin qenë tërësisht të hapura, atëherë 24 deputetë, të cilët u mandatuan nëpërmjet aplikimit të listave pjesërisht të hapura, apo 17.1% e numrit të përgjithshëm të deputetëve në Kuvend, nuk do të rezultonin si deputetë nominalisht të zgjedhur, dhe si të tillë, do të ishin zgjedhur kandidatët e të njëjtit subjekt, të cilët kishin fituar një numër më të lartë të votave preferenciale.

Së katërti: Amendamentet e propozuara parashikojnë mënyrën e përllogaritjes dhe shpërndarjes së mandateve nëpërmjet;

Aplikimit të një formule që realizon llogaritje me kuotë proporcionale dhe shpërndarje të mandateve të plota të fituara nga cdo subjekt në nivel qarku, në favor të kandidatëve të listës që kanë marrë përqindjen më të lartë të votave dhe korrektimin e rezultatit në shkallë vendi.

Ky model bazohet në;

a) Në përcaktimin e votave të domosdoshme për një mandat dhe shërben për përcaktimin e mandateve të plota që fitojnë subjektet zgjedhore në nivel zone zgjedhore – qark dhe në shkallë vendi.

b) Ndarja e mandateve për subjektet zgjedhore bëhet nëpërmjet formulës me kuotë. Kuota përcaktohet duke pjesëtuar numrin total të votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore, me numrin e mandateve të caktuara për t`u shpërndarë në atë zonë zgjedhore.

c) Subjektet zgjedhore përfitojnë secili aq mandate sa është numri i plotë që del nga pjesëtimi i votave që ka marrë subjekti në zonën zgjedhore, me kuotën mesatare të votave për një mandat në zonën zgjedhore përkatëse.

d) Nëpërmjet së njëjtës procedurë bëhet shpërndarja e mandateve që rezultojnë të pa shpërndara, duke e korrektuar rezultatin në rang vendi. Nga numri i mandateve të llogaritura për të përfituar subjekti zgjedhor në rang vendi, zbritet numri i mandateve të fituara nga ai subjekt në nivel zone zgjedhore.

e) Pas shpërndarjes së mandateve për cdo subjekt zgjedhor, KQZ-ja përcakton shpërndarjen nominale të mandateve në favor të kandidatëve të listës, duke filluar nga kandidati me përqindjen më të lartë të votave që ka fituar deri në mbarimin e mandateve të përlogaritura të fituara nga subjekti zgjedhor.

Modeli i shpërndarjes së mandateve si më sipër, me kuotë proporcionale, dhe me korrektim në shkallë vendi, përmbush në mënyrë të plotë parimet kushtetuese dhe standartet ndërkombëtare të parashikuara në “Kodin e Praktikës së Mirë...” të Komisionit të Venecias.

f) Në cdo rast, si në nivel qarku, ashtu edhe në rang vendi, shpërndarja e mandateve do të bëhet në favor të kandidatëve të renditur në bazë të rezultatit në përqindje më të lartë të votave preferenciale të fituara prej tyre. Ky rregull nuk do të zbatohet nëse kandidati me rezultat më të vogël i përket gjinisë më pak të përfaqësuar.

Argumentet sa më sipër, marrin në konsideratë edhe opinionin e shumicës së qytetarëve në vendin tonë. Instituti i Studimeve Politike në Shqipëri, pas një sondazhi dhe analize mbi të dhënat e rezultuara nga gjetjet e aplikimit të projektit “Morning the 2021 Parliamentary Elections in Albania” ka konkluduar se:

“Mbi 86% të qytetarëve janë “Pro” hapjes së listave dhe votës parapëlqyese pa prag dhe kufizim. Në zgjedhjet e 25 Prill 2021, mbi 70% e votuesve kanë shprehur nëpërmjet votimit, preferencën e tyre në zgjedhjen e kandidatëve”.

Së pesti: Projektligji propozon; përdorimi i sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë në votim, të zbatohet brenda datës 1 Prill 2025, në të gjitha qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave në rang vendi.

Në këtë kuadër, vlen me rëndësi të përmendet se ende nuk janë krijuar kushtet praktike për aplikimin e votimit dhe numrit të përgjithshëm të zgjedhjeve në cdo fazë të implementimit, në plotësim të detyrimit të sanksionuar në nenin 22 pika 1 e Kodit Zgjedhor, i cili në përkufizimin jo më pak se 10%, krijon mundësinë e zvarritjeve në përsheptimin e këtij procesi, pavarësisht rrethanave të faktit.

Përdorimi i teknologjisë në zgjedhjet e vitit 2021 dhe ato të pjesshmet lokale Mars 2020 u pilotua i kufizuar. Në përfundim të këtyre zgjedhjeve, ky lloj procesi rezultoi si mjaft i sukseshëm dhe i besueshëm si nga rreth 85% të zgjedhësve shqiptarë, ashtu edhe nga KQZ, e cila në raportin e saj e konsideroi procesin si mjaft të suksesshëm.

Në këto rrethana, për zgjedhjet e vitit 2023, KQZ-ja kërkoi që aplikimi të zgjerohej më tej duke u shtrirë në 6 bashki të vendit si në; Fier, Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër, bashki të cilat përfshijnë së bashku rreth 50% të votuesve në shkallë vendi apo 2180 qendra votimi.

Me gjithë kushtet e krijuara në pikëpamjen e rezultateve të konfirmuara të këtij procesi, synimi i rritjes dinamike aq shumë e kërkuar dhe e mundshme teknikisht, u pengua për shkakun e pajustificuar për mungesë fondesh për të përballuar zgjerimin e projektit, i cili ishte llogaritur në rreth 50 milionë \$.

Në vlerësimin e propozuesve të projektligjit, shfrytëzimi i cdo mundësie për të siguruar fondet e mjaftueshme për financimin e projekteve të tilla të rëndësishme me impakt të lartë në besueshmërinë e rezultatit zgjedhor, do të justifikonte dhe përballimin e tyre me kredi afatmesme, duke e konsideruar nevojën strategjike dhe emergjente në luftën kundër korrupsionit dhe manipulimit zgjedhor.

Së gjashti: Në Kushtetutën e vendit tonë, e drejta e njeriut për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur, përcaktohet si e drejtë themelore dhe si e tillë ajo gjen shprehje të plotë në normat kushtetuese përkatëse, të cilat në raport me të drejtën pozitive të shtetit, janë të drejta pararendëse superiore.

Gjithashtu e drejta jonë kushtetuese evokon shprehimisht edhe një tërësi kufizimesh, ndër të cilat dhe kufizimin për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur një kategori të caktuar shtetasiht, në përputhje me përcaktimet e nenit 69 të Kushtetutës, në pikën 1 të së cilët sanksionohet se:

“Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputet, pa hequr dorë nga detyra;”

Në vështrim të kësaj dispozite kushtetuese, është shprehur qartësisht dhe në mënyrë taksative ndalimi i kandidimit dhe zgjedhjes deputet.

Në kundërshtim flagrant me përcaktimin sa më sipër, nëpërmjet ligjit nr.74/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” është bërë një ndryshim (i cili është reflektuar në nenin 63 pika 4 të Kodit Zgjedhor), sipas së cilit “**nuk mund të rregjistrohen si kandidatë për këshillat vendor pa hequr dorë më parë nga detyra** e gjithë kategoria e funksionarëve, të cilët janë të ndaluar nga Kushtetuta” të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputet pa hequr dorë nga detyra.

Krahas antikushtetutshmërisë së këtij ndalimi, administrata zgjedhore në praktikën e saj të rregjistrimit të kandidatëve për këshillat vendore, ka bërë dhe një ndalim extra, duke ndaluar kandidimin pa hequr dorë më parë nga detyra për të gjithë punonjësit e arsimit të mesëm profesional dhe personelit të administratës së drejtorive arsimore, si dhe shkollave të mesme profesionale, duke cënuar kështu haptazi liritë politike të shtetasve, të cilat si të tilla sanksionohen dhe normohen vetëm sipas parashikimeve strikte kushtetuese.

Kjo problematikë shqetësuese përbën një akt të paprecedent flagrant të kundraligjshëm, i cili është nxitur nga aktet urdhëruese të Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Financave (për të cilën është vënë në dijeni dhe KQZ-ja), të cilët në kundërshtim të hapur me tagrat e tyre, kanë urdhëruar **pezullimin e menjëhershëm nga puna për personat që kandidojnë për këshillat vendore, pavarësisht statusit të tyre si pedagogë, mësues apo punonjës të thjeshtë të personelit administrativ, ose të vetëtërhiqen nga ushtrimi i së drejtës së tyre për kandidim**”.

Referuar sa sipër, grupi i deputetëve kërkojnë riformulimin e nenit 63, pika 4 të Kodit Zgjedhor që të shmanget antikushtetutshmëria që ai sjell në cënimin e së drejtës së

kandidimit për këshillat vendore, si dhe për sa ai atakon rregullimet e sanksionuara në nenin 69 të Kushtetutës së vendit tonë.

Së shtati: Ndryshimi pa paralajmërim në zgjedhjet e vitit 2013 i qendrave të votimit për rreth 1.3 milionë zgjedhës, kontrolloi dhe në shkallë shumë të lartë në të gjithë vendin rezultatin e zgjedhjeve, duke ndikuar hapur në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.

Rezulton e provuar se ndryshimi i qendrave të votimit, bëri që rreth 200 mijë votues të paraqiteshin në qendrat e votimit të gabuara, për shkak të konfuzionit, një numër i madh i këtyre votuesve nuk ushtruan të drejtën e tyre për të votuar.

Nenet 50 – 52 të Kodit Zgjedhor, përmbajnë rregulla të rëndësishme dhe të detyrueshme për kryetarët e bashkive, lidhur me hartimin e listës së zgjedhësve, lidhur me qendrën e tyre të votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj.

Neni 52 parashikon se brenda 60 ditëve nga publikimi i extratit të përbërësve të zgjedhësve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, kryen lajmërimin me shkrim të zgjedhësve. Gjithashtu, kjo dispozitë parashikon se “Kryetari i Bashkisë, ka detyrimin ligjor, të paktën një herë në javë, të raportojë përpara KQZ-së për përmbushjen e këtij detyrimi dhe për mos përmbushje, ndaj tij ndërmerret masa administrative e gjobës.

Nga analiza e konstatimeve të bëra, kanë rezultuar shkelje të tilla të cilat kanë shmangur me dashje dhe në mënyrë abuzive, zbatimin e njoftimit për rreth 1.3 milionë zgjedhës. Nëpërmjet mosveprimit të tyre, kryetarët e bashkive kanë penguar zgjedhësit për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhjeve dhe për rrjedhojë, kanë krijuar pasoja flagrante të kundraligjshme, në shkelje të hapur të detyrimeve të përcaktuara në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor.

Reforma Zgjedhore që po kryhet aktualisht, duhet të adresojë ndryshimet e nevojshme për të disiplinuar plotësisht njoftimin e zgjedhësve, duke konsideruar cdo shkelje të këtij detyrimi, si një fenomen të lidhur drejtpërdrejtë me rezultatin e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, nëpërmjet shtesës së pikës 7 të nenit 52, propozohet që kur shkelja e detyrimit për njoftimin me shkrim të zgjedhësve, kur kjo nuk përbën vepër penale, të dënohet me gjobë nga 500 mijë deri në 1 milionë lekë.

Propozimet sa parashtruar në projektligjin e propozuar, garantojnë përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën e Shqipërisë dhe standartet ndërkombëtare mbi zgjedhjet, të njohura dhe të pranura nga shumë vende anëtare të OSBE/ODIHR.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, bashkëpunimin dhe besimplotë për angazhimin tuaj në miratimin e projektligjit që ju parashtruar.